



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë
RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 4 datë 16.10.2020

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 7 datë 8/10/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për një ndryshim në Vkb Nr 64 Datë 27.12.2024, Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" i ndryshuar"

Analiza ligjore: Eshte në mbështetje te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë "të ndryshuar; ligjit 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" te ndryshuar; ligjit nr.115/2024 "Per buxhetin e vitit 2025", i ndryshuar; Udhëzimit Plotesues te Ministrise se Financave nr.2, date 24.01.2025 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025", VKB nr.64, date 27.12.2024 I ndryshuar "Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtar 2025-2027 të Bashkise Pukë", të ndryshuar. sipas materialit te përgatitur nga administrata e Bashkisë me propozim te Kryetarit te Bashkise Pukë.

Situata aktuale dhe financiare e funksionit:

Duke qene se bashkia ka bere proceduren e shitjes ne ankand te futboll Terbuni nuk kemi llogarit buxhet per 6-mujorin e dyte viti 2025.

Duke qene se procedurat e ankandit kane deshtuar jemi të detyruar te bejme ndryshime ne buxhet duke shtuar dhe pakesuar sipas mundesise financiare ne strukturat sipas projektit, po keshtu dhe nje ndryshim ne fondin e pagave per sherbimet publike. Per Sport dhe argetim zeri ne buxhet do te behet ne 4,000,000 leke dhe dhe Sherbimet Publike vendore do te rritet me 2,000,000 Leke.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Financës ka relatuar përpara komisionit për miratimin e projektvendimit " Për një ndryshim në Vkb Nr 64 Datë 27.12.2024, Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" i ndryshuar"

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme drejtorinë e Finances ose Drejtorinë përgjegjëse për informacione te tjera te nevojshme.

Impakti social / grupet që preken: Dokumenti i propozuar Për një ndryshim në Vkb Nr 64 Datë 27.12.2024, Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" i ndryshuar" ndikon në gjendjen financiare të Bashkisë.

Komisioni i Përhershëm për "Ekonomi dhe Financë", i mbledhur me datën 16/10/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.7 datë 08/10/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për një ndryshim në Vkb Nr 64 Datë 27.12.2024, Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" i ndryshuar" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.


Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI


1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit



Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)



Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Datë 16.10.2025